



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK)

dhe

Kompanisë Melodia Sh.p.k. Nui: 810073594

### Neni 1 – Palët kontraktuese

Kjo marrëveshje lidhët ndërmjet:

1. Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK), me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Kryetari i saj, Z. Avdi Hoti dhe Kompanisë Melodia Sh.p.k., e regjistruar në Republikën e Kosovës me NUI: 810073594, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Drejtori: Astrit Gashi.

### Neni 2 – Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e furnizimit me tekstile dhe produkte të ngjashme, me qëllim që pjesëtarët e PK-së dhe anëtarët të Sindikatës së Policisë së Kosovës t'u mundësohet përfitimi i një zbritjeje prej 20% në produktet e ofruara nga kompania Melodia Sh.p.k.

### Neni 3 – Përmbajtja e bashkëpunimit

1. Kompania **Melodia Sh.p.k.** angazhohet t'u ofrojë të gjithë pjesëtarëve të **Policisë së Kosovës** një **zbritje prej 20%** nga çmimi i rregullt për të gjitha produktet tekstile që ajo ofron. Kjo zbritje **nuk aplikohet për produktet që janë tashmë në ofertë apo në zbritje** në momentin e blerjes.
2. Kjo zbritje zbatohet vetëm për blerjet e realizuara nga pjesëtarë e PK-së, të identifikuar me dokumentacion zyrtar ID.
3. Kompania mund të organizojë oferta të posaçme, koleksione apo linja të dedikuara për Policinë e Kosovës, në koordinim me SPK-në.

### Neni 4 – Detyrimet e palëve

1. SPK do të njoftojë anëtarësinë dhe pjesëtarët e PK-së për këtë marrëveshje dhe do të sigurojë identifikimin korrekt të anëtarëve dhe pjesëtarëve gjatë blerjeve.
2. Melodia PX do të zbatojë me korrektësi përqindjen e zbritjes së dakorduar dhe do të mbajë një trajtim korrekt e transparent ndaj çdo anëtari të SPK-së.

### Neni 5 – Kohëzgjatja e marrëveshjes


Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për periudhën njëvjeçare, me mundësi rinovimi automatik me marrëveshje të ndërsjellë të palëve.

## Neni 6 – Dispozita të përgjithshme

1. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë marrëveshje bëhet vetëm me pajtimin e të dy palëve në formë të shkruar.
2. Marrëveshja hartohet në dy kopje identike, një për secilën palë.
3. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, palët angazhohen që çështjet t'i zgjidhin në mënyrë miqësore përmes dialogut të drejtpërdrejtë.


## Neni 7 – Nënshkrimet

Për Sindikatën e Policisë së Kosovës




z. Avdi HOTI,

Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës



Për Kompaninë Melodia Sh.p.k.



Astrit Gashi

Drejtor Ekzekutiv

